

ZIJA ÇELA
ORA E ZOOPARKUT
ROMAN

BOTIMET TOENA

Zija Çela

Ora e Zooparkut

Roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore letrare: Anrila Spahija

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Ana Shema

Në kopertinë: *Fragment nga* Marc Chagall

ISBN 978-9928-235-38-1

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Videmus nunc per speculum
et in aenigmate...

Nëpërmjet një pasqyre
dhe errshëm shohim tani...

Shën Pali

(1. Korintasve, XIII, 12)

Spirale

Ajo kishte filluar të ngazëllente me dashnorin, thua se tek ai mashkull kishte hasur ndonjë maço sa gjashtë burra, prandaj duke shtuar edhe një kat nga vetja, pikërisht ripërtëritjen e saj, ndihej si në qiellin e shtatë. Midis lajthitjeve të tjera, ideja fikse se gjatë natës arrinte të dëgjonte zhurmën e yjeve të reja, më dukej një sajese qesharake. Po aq acaruese delikatesa e shtirë për pasqyrën dhe tualetin e mbrëmjes, këmishën me dantella dhe të brendshmet e mëndafshita, sepse në gjumë gërhinin të dy, ajo gërnetë dhe ai trombë.

Një mbasdite, teksa binin hijet e muzgut, e gjeta të përlotur. Nuk ma fshehu, në atë molisje të ëmbël tha se qante nga lumturia. Tha, pastaj, se lotët e sinqertë ngjiten lart, ata arrijnë deri në kufijtë e jashtëm të kozmosit, që prapëseprapë janë zona hyjnore dhe atje kthehen në yje. Nga të gjithë lotët, mjaftojnë pesë të tillë për një yll rishtar. Kështu ndodh, tha, që galaktikat shtohen

gjithnjë, qielli zgjerohet e zgjerohet, ndërsa edhe zemra e njeriut bëhet më e madhe bashkë me universin.

O Zot, ku po e hidhte fjalën, nga i kishte këto broçkulla dhe si u besonte verbërisht?! Mua s'më mbetej, veçse të kujtoja thjeshtësinë e saj të mëparshme. Për shembull, nuk më hiqej nga mendja çasti kur, sa herë qepte diçka me gjilpërë, në vend të gërshërës e këpuste fillin me dhëmbë.

Ata dhëmbë, tashmë, sikur bluanin mishin tim.

- Çfarë shkruan ti në blloqet e tua? - u bë kureshtare po atë mbasdite.

Ia ktheva naivisht, si të mos e kisha parasysh me ç'bllok në dorë më kishte parë herën e fundit:

- Në cilin, në atë me spirale?

- Po, - tha, - atë me sustë ndër faqe.

Është e vështirë të kesh veshë aq të mprehtë, sa në mes të rrëmujës kaotike të jetës, dramës dhe shpresës, të kapësh tingullin që të duhet ty. Pak nga pak, unë po mendoja se kisha trashëguar dështim dhe mungesë kontrolli në fatin tim. Me vete e pranoja, asnjëherë s'kisha qenë i zoti të ndryshoja fatin e dikujt tjetër, por edhe imi po më dilte nga dora.

Thonë se të gjithë dështakët, me kalimin e kohës, përngajnë me njëri-tjetrin. Ndoshta unë i përkas kësaj specie, andaj nuk është çudi nëse u ngjaj dështakëve. Megjithatë, ndonjë përgjigje përfundimtare nuk kam, përderisa më duket se asnjëri prej tyre nuk më ngjan mua.

Kurthi

Nuk më kujtohet kush pati shkruar se dragonjtë i sulmonin elefantët pikërisht në verë. Vapa ishte aq kapitëse, e rëndë dhe me lagështirë, sa të shkonte mendja se po të flije, nuk do të zgjoheshe më, pasi do të shpërbëheshe në krevat. U ngrita ende pa zbardhur, por pa mundur të qetësohesha, sepse të njëjtat dyshime dhe të njëjtat mëdyshje më brenin. Ai që do të sulmoja unë, nuk ishte elefant; sipas vëzhgimeve të mia ishte një dykëmbësh skërfyell, një tip skuthi që me gjithë feçkën e madhe, mund t'ia thyeja turinjtë me një grusht. Mirëpo deri atëherë ai kishte ruajtur ndaj meje një gjakftohtësi ngulmuese, dinake e tallëse, si të donte të më thoshte me atë vështrimin rrëshqitës: “Pse shet dëngla?! Unë e di se ti e di që Fjonën tënde e palloj.”

Këtu më bëhej i besueshëm sulmi i dragonjve, të cilët i përvëlonte mbajtja e flakës në grykë. Me gjasë, ata e kishin provuar se gjaku i elefantëve mbetej i ftohtë në verë. Kurse unë në këtë pikë çaloja. Për t'i kapur në

flagrancë, domethënë të dy bashkë në krevat, ende më mungonin provat.

Në fundjavën tjetër, kur tashmë kishte rënë vapa e madhe, ngrita edhe kurthin. Të shtunën në mëngjes i thashë asaj se isha ftuar në B. dhe se prej andej do të kthehesha të nesërmen. A do ta sillte atë natë jaranin në shtëpi? Kërkoj ndjesë që nuk përdora fjalën e mëhallës, *palluesin*.

Në B. do të shkoja vërtet, madje edhe Fjona i kishte shtruar bukë dikur mikut tim të hershëm. Me Roni Krisilin (alias Edmond Kristo do të më dalë) isha njohur qysh në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja, kur studionim në degën e italishtes. Ai i ndërpreu befasisht studimet e larta pa mbaruar vitin e dytë. Por si ta kishte tërhequr këmbën zvarrë, as unë nuk arrita të diplomohesha. Një pneumoni me ujë, që m'u përsërit pas disa kohësh, më shkëputi nga universiteti në prag të vitit të katërt. Kurimi zgjati me muaj, herë dilja, herë kthehesha në sanatorium. Më pas, si të më ishte veremosur gjithçka, i solla shpinën fakultetit dhe u rropata për ndonjë punë.

Babai i Ronit, Maznik Krisili, të cilin e kisha lajmëruar një ditë më parë, më priti bujarisht. Ai s'e harronte kurrë, siç më tha, dashamirësinë që kisha treguar ndaj djalit të tij, një copë fshatari që kishte guxuar të përzihej me elitën e kryeqytetit. (Fjalët e tij, por dyshova se mund t'i kishte dëgjuar në atë kohë nga i biri.) Veçse shfaqti habi që nuk kisha bërë prokopi, pasi ende mbaja motoçikletën e vjetër, një skuter rrangallë, që e përdorte edhe Roni përpara se të emigronte në Itali. Por edhe unë u habita gjithashtu. Dikur kisha parë atje

një shtëpi të vogël, tani po shihja një bina trekatëshe me oborr, kopsht të madh dhe një rrethojë betoni mbi dy metra të lartë përqark. Aq e mobiluar m'u duk brenda, sa mendova se me xhepin tim nuk do të mund të paguaja as dorezat e praruara të dyerve.

Mbasdite dolëm për gjah nëpër ullishte me një çifte gjermane, që i kishte tytat një përmbi një. Për mua ishte hera e parë që do të qëlloja me armë dhe, ngaqë e ndjeu se isha fillestar, nuk priti të vrisja ndonjë shpend, por vuri ca kanaçe birre në trungjet e ullinjve dhe, në largësi prej tridhjetë hapash, më la të shtëpia pesë herë. Pastaj, po nga çanta e nuzullimeve, nxori një pistoletë Zastava dhe nisi t'i rrëzonte kanaçet, duke i qëlluar në ecje e sipër, madje njëherën edhe në pozicion rrotullimi si kauboj. S'e pyeta pistolierin, që dukej i stërvitur, se e kujt ishte pistoletë, por më shkoi nëpër mend se njëherën, revolen ose çiftin, mund ta kishte pa leje. Megjithatë, kur disa orë më vonë do të ndodhesha në rajonin e policisë, përmenda vetëm çiftin, Zastavën s'e zura ngoje.

Darkën e morëm me ngadalë. Maznik Krisili hante e pinte, ndërsa unë vetëm sa e vija gotën në buzë, sepse do të ngisja motorin në kthim. Ia kisha thënë shkaku përse do të kthehesha patjetër, e kisha lënë Fjonën me temperaturë. Kurse ai bujari, duke dashur shoqëri në pije, nisi të ngulmonte që të gdhihesha aty. Kaq në siklet më vuri përgjërimi i tij, sa u detyrova t'i rrëfeja arsyen e vërtetë. Me këtë rast, mendova, mund të marr edhe ndonjë këshillë prej një burri të pjekur, të rrahur me përvojë. Vriti të dy, më tha. Dhe, si u mendua pak, e ndau barrën përgjysmë: Ti laji vetë hesapet me atë zuskën

tënde, ndërsa jaranin ia lëmë Ortakut tim. Ai gjakësori e di pastaj, e kryen vetë apo paguan dorasin, kjo është puna e tij. Por bashkë me atë horrin që të poshtëron ty, varroset edhe e vërteta.

Për ta bërë sa më të besueshme këtë mundësi, ai më tregoi mënyrën si ishte zaptuar trualli i vilës. Shih atë çast, prej drithmave që më hynë në trup, e rrëkëlleva gotën me fund. Ishte verë e holluar me ujë, por më tepër ujë që kishte marrë ngjyrën e verës rozë.

Teksa kthehesha mbasandaj, nën dritën e fenerit më zuri syri një këmbë njeriu, që kishte dalë mbi buzën e kanalit. Isha ende në xhadenë e fshatit, rreth treqind metra pa arritur rrugën ndërqytetëse. Kur e ndala motorin, u tmerrova. M'u duk se Maznik Krisili dhe Ortaku i tij ishin marrë vesh tashmë me telefon dhe, për të më bindur ç'burra të fjalës ishin, ma kishin nxjerrë përpara atë kurban, duke flijuar ndonjë kalimtar të rastit.

Nuk pata asnjë shestim nëse, në rrethana të tilla, kisha apo nuk kisha ndonjë detyrim ligjor. Isha njeriu që edhe në xhunglën pa ligje, sapo sheh dikë përtokë, harron punët e veta dhe nxiton për t'i vajtur në ndihmë. Pasi kërceva në kanal, i vura njërin dorë prapa kokës, me tjetrën ia zura këmishën në kraharor dhe u përpoqa ta ngrija. Por nuk u përmend. Vetëm krahët iu varën dhe këmba e djathtë, si ta kishte prej druri, i ra një cope në kanal. I tromaksur, duke ndier si m'u lagështitën duart, e shtriva sërish në kokërr të shpinës. Atëherë, po në hutim

e sipër, i telefonova policisë. Mbasi njoftova se kisha gjetur një kufomë, nga salla operative më pyetën për gjeneralitetet, vendin e saktë ku ndodhesha, çfarë kisha konstatuar te kufoma, pastaj më porositën që të mos i prishja provat, as të mos lija njeri të afrohej.

Të parët ia mbërritën me veturë dy policë të patrullës, por nuk mënoi edhe furgoni me grupin hetimor. Kaq debil u tregova, sa pandeha se tashmë mund të largohesha. Në atë orë kisha filluar të llogarisja me vete edhe minutën, derisa të gjendesha në shtëpi. Megjithëse e kisha çelësin, e merrja me mend se derën e jashtme të apartamentit nuk do të mund ta hapja. Por ajo fyçka dhe ai tyçi do të kapeshin gafil gjithsesi, sepse do të vinte çasti që të ma hapnin derën, pasi të ishin veshur. Ashtu e kam hallin dhe nxitoj, fola në tym, kam një hall fragrance, mund të largohem tani?.. Mirëpo doli se nuk mundesha. Vendi i ngjarjes ishte përshkuar me shirita, ku shkruhej: Skenë krimi, mos kaloni. Dhe unë ndodhesha brenda atij rrethimi.

Dukej se aty secili kryente detyrën e vet. (Dikush po fotografonte me blic.) Ndërkohë e dallova prokurorin e gatshëm, ngaqë i jepte urdhra grupit, si dhe oficerin e policisë gjyqësore që, para se të më merrte në pyetje, priti të më kontrollonin fizikisht mos mbaja armë. “Por unë kam qëlluar me armë”, më shpëtoi mua, “mbasdite kam qëlluar kanaçe birre, kurse tani i kam duart me gjak.” Të gjitha mjetet, edhe ambulanca që sapo kishte ardhur, i mbanin të ndezur fenerët dhe unë pashë si i luajtën vetullat oficerit, thua se po qeshte me mua, kur përsërita: “I kam duart me gjak.”

Pas mbledhjes së provave në terren, në rajon nisën të më pyesnin nga e para, sikur ta kishin harruar seancën në vendngjarje. Ata këmbësheshin me njëri-tjetrin. Herë më pyeste prokurori, herë oficeri i gjyqësorës. Dhe unë njëlloj, e kam një hall të ngutshëm, mund të largohem tani? I pari, që kishte poshtë nofullës një gjëndër dhjamore si një bumballë, ma kthente shkurt, jo, jo. I dyti, të cilit s’i hiqej nga fytyra prishja e buzëve dhe një pakënaqësi sflitëse, luante vetullat. Por edhe mua po më vinte të luaja mendsh, sepse ishin të njëjtat pyetje, për të cilat kisha të njëjtat përgjigje. Prandaj u habita kur, përveçse nga gjaku i viktimës në shuplaka, edhe nga rrobat e kurrizi i duarve më morën kampione për mbetje pas qitjes. Ende pa i çuar kampionet në laborator, në fjollat e pambukut bloza e barutit dukej me sy të lirë. O Zot, në ç’telashe e kisha futur veten, duke dashur të ndihmoja tjetërkënd!

Kushedi përse, prokurorin nuk e ndërpreva më, por sapo i jepja një përgjigje, oficerit thujse i përgjërrohsha për t’u larguar. Si të ishte shurdh, ai vazhdonte në të tijën: “E mirë, ke pohuar se me viktimën nuk ke pasur ndonjë konflikt. Por kur e ke takuar për herë të fundit?” “Për herë të parë dhe të fundit e kam parë në kanal. Sepse, përderisa s’e kam njohur, si mund ta kem takuar?! Unë nuk e di as kush është, as ku banonte dhe as me çfarë merrej. E kam një hall me nxitim...” “Mjaft na çave kokën, nuk mund të largohesh!”, iu shtua sflitja në fytyrë.

Vetëm të nesërmen, kur po afronte dreka, më lanë të lirë. Gjithë sa kisha thënë për çiften me tytat një mbi një,

për kanaçet në degët e ullinjve, etj., ishin provuar. Në vilën e Maznik Krisilit ishin gjetur edhe pesë gëzhhojat boshe në kollan. Gjithsesi, m'i morën shenjat e gishtave dhe më thanë se, po të kishin nevojë, do të më thërrisnin përsëri gjatë hetimeve.

Teksa do të dilja, oficeri i policisë gjyqësore më pa në korridor dhe u kujtua:

- Tani s'po të shoh të nxitohesh.

- Tani është e kotë, - thashë, - nuk pi më ujë.

- Sikur përmende një flagrancë në fillim... Të dashurën do të kapje?

- Nuk kam të dashur.

- Kaq i ri dhe qenke martuar?

- Nuk jam i martuar.

- Po atëherë, kë do të kapje në flagrancë?

- Do të kapja nënën, - thashë. - Jam i bindur se natën është shkërdhyer me një pusht, që ia ka bërë trurin çorbë me makarona yje.

- Mos e vrit mendjen, - tha, - edhe ne po na qihet nëna në punë! Shpesh s'kemi kohë të hamë një pjatë makarona në shtëpi.

Do ta mallkoja veten rrugës, ç'djallin pate që iu hape si qyqan një të panjohuri?! Nuk kisha përgjigje tjetër, veç faktit se për nga shtati, flokët me krela dhe prishja e buzëve, ai tipi i ngjante babait tim, ndjesë pastë, siç e kisha parë në fotografi. Vetëm teksa ecja më këmbë (motorin dhe celularin do të ma kthenin pas disa ditësh), e kuptova lëmshin që ishte krijuar. Unë isha bërë i dyshuari i parë për një akt që e kishte kryer tjetërkush, por që ia kishte dalë ta maskonte dorën. Po merrja një

mësim të paharrueshëm për fajësinë e fshehur. Në rastin e dytë, kur do të më duhej ta thërrisja sërish policinë, do të mendohesha gjatë.

Por herën e tretë do të mbyllja sytë, duke e shmangur me dashje.

Ndërkaq, nëna ime kishte fjetur me dashnorin, atë skapellon që e kisha parë të takohej me Fjonën edhe poshtë pallatit. Si për të dielën e ngeshme, i gjeta duke pirë aperitivin e drekës. Me gota të larta, që kishin fron të gjerë (Bandilli i kishte sjellë?), pinin spumante. Dhe mbi tryezë një gotë bosh, kinse duke më pritur mua. Por kur skuthi u ngrit më këmbë dhe nëna deshi të thoshte diçka për praninë e tij, pashë se e vononte fjalën, ngaqë e kishte zënë urthi dhe lemozonte vazhdimisht.

- Nuk ka nevojë, e njoh këtë surrat, - e ndërpreva. Dhe siç isha i mbushur në polici, iu zbraza: - I thuaj se herë tjetër s'ka alibi, do ta vras po e gjeta në këtë shtëpi!

- Ç' thua kështu, Martin?! - u patak ajo. - Që sot e tutje, zoti Terenc Haskodeci do të bashkëjetojë me ne.

- Zoti Skilipeci, - ia katranosa mbiemrin me kast, siç më erdhi ndër mend, - do të bashkëjetojë me ty, por kurrsesi me mua!

Dhe pas këtij paralajmërimi gjithë nerva, u mbylla në dhomën time.

Dikush qan e dikush qesh

Ne banonim diku pranë Parkut të Madh të kryeqytetit, në një kompleks pallatesh që formonin një oborr të brendshëm në trajtë katërkëndëshi. Mu në mes ishte një shatërvan i vogël, ndërsa dy katet e para kishin butikë, markete, zyra shërbimesh, agjenci udhëtimi dhe parfumeri, por sidomos kafene. Mëtuesi i nënës sime kishte në pronësi një Sallon Mix Fa me fustane nusesh, që ose mund të bliheshin, ose mund të merreshin me qira. Por aty shërbeheshin edhe veshje për pagëzime, aksesore dhe zbukurime festash, pritjesh apo ditëlindjesh. Kështu që në oborr kishte vazhdimisht lëvizje dhe zor ta merrje vesh kush ishin banorë, kush frekuentues të rastit.

Babai më kishte lënë foshnjë, prandaj s'e dija qëkur nëna e kishte lëshuar mbiemrin e burrit, për t'iu kthyer sërish të sajit. Me gjasë, prej vitesh nuk njihej më si Fjona Labora, por Fjona Loro Kokona.

“Kur isha e re dhe dilja nëpër rrugët e qytetit”, e kisha dëgjuar t'i rrëfente jaranit, “meshkujt kthenin

kokën, duke e ngritur zërin: Shihni, shihni si vezullon Kokona! Në vendlindjen time *kokonë* i thonë kukullës. Dhe ata donin të thoshin: Shihni, shihni si shkëlqen perria, hyria, bukuroshja e qytetit.”

Im atë punonte me një autocisternë dhe, gjatë udhëtimeve furnizuese, atje e kishte njohur. Prindërit e saj nuk kishin dashur t’ia jepnin një “shoferi vagabond me shtëpinë në krah”, prandaj ishin martuar me grabitje, domethënë pa ceremoni dasme. Ndoshta për shkak të trupit të hedhur, këpucëve spic, xhaketës prej lëkure dhe fytyrës së zeshkët, me mustaqet pikante e flokët krela-krela, prindërit e nuses e kishin gjykuar si aventurier. Dhe, sipas Fjonës, nuk ishin gabuar. Mirëpo pas viteve të para, ndërsa asaj po i binte vesku, ai maloku qëndronte pors i lis, një ashkël s’po ia hiqte koha, ndonëse për nga mosha kishte njëmbëdhjetë vjet mbi të shoqen.

David Jakin Labora e kishte kthyer kabinën e kamionit në njëfarë gardërobe shëtitëse. Përveç ndërresave të brendshme, aty mbante edhe kostume, këmisha e kravata, veglat e rrojës, parfumin dhe patjetër ndonjë shishe pije. Ndërsa kur e zinte nata rrugës dhe ulte krevatin e kabinës, nuk dihej nëse flinte vetëm a me kënd. “Kamionist hesapi”, psherëtinte Fjona, “kamionist dhe sevdalli i pjergullës!” Kështu e kujtonte tim atë. Me *sevdalli i pjergullës* donte të thoshte se ishte pijanec, ndërsa me krevatin e kabinës... Një të ashtuquajturën Dolores Kamenica nuk e përjashtonte nga kurvërimi në kamion. Por meqë aksidenti fatal, gremisja në rrugën e Dajtit, kishte ndodhur me veturë dhe aty prapë me të dashurën, Fjona Kokona shfrynte nganjëherë: “Ah,

kur s'ndodhi me cisternën e benzinës, t'u hynte flaka tejpertej dhe të mos u gjendej më as nishani!" Vallë, ia thoshte edhe këtë palluesit të saj?

Me skilipecin (Ekziston kjo fjalë në Fjalor?) kam parasysh një djalë të ri, thujse të moshës sime, i gjatë dhe më tepër se i hajthëm. Shkurt, një skapello me pak bazament muskujsh dhe të cilit, prej hundës së madhe me kurriz, një anë e fytyrës i rrinte thujse gjithnjë në hije. I hollë si mënjollë, imagjinoj t'i ketë thënë Fjona mikeshës së saj, parukieres Huva Jakova. Nëna kishte gati dyfishin e moshës së tij, ai sapo i kishte mbushur të njëzetepesat, ndërsa ajo po u afrohej të dyzeteshtatave. Përse dreqin nuk ishte martuar pas vdekjes së burrit, kur ishte ende aq e re! Dhe meqë i kruhej tani, përse nuk gjente një bashkëjetues të përshtatshëm?! Ai kërthingla më dukej edhe i çuditshëm, edhe i pabesueshëm. Ose ishte maniak dhe i pëlqente pula plakë, ose një mashtrues që, në vend të shpenzonte për seksin nëpër Pub-e e motele, e kishte gjetur Fjonën hazër dhe gratis.

Pavarësisht bindjes sime, Terenc Haskodeci sillej njëlloj si ajo fyçka, pra sikur kishte rënë brenda këmbë e kokë edhe ai. Ne kishim një banjë të vetme dhe, kur bënte dush, më duhej të prisja duke shtrënguar dhëmbët, në mënyrë që të mos e hapja derën me shkelma. Zotëria e tij nuk ngutej. Nën rrëkajën çlodhëse të ujit, si t'i çonte ndonjë telegram besnikërie Fjonës, këndonte gjithë afsh: Të ka lali shpirt, të ka lali xhan, të ka lali yll, o sa shumë të dua!.. Dhe kjo shushka ime, duke e dëgjuar, shkrihej nga lezeti. Pastaj, midis lalit e laleshës kriste muhabeti, sepse me ta ndalur çezmën ai, Fjona afrohej

te dera. Ndodhte, madje, që prej aty ia merrte këngës edhe ajo, të ka lali xhan, të ka...

“Mut e ke!” e ndërpreva njëherë nga tërbimi.

Por çfarë më acaronte më tepër ishte seksi i tyre. Një perde muri me tek tullë na ndante. Kur ia dëgjoja Fjonës rënkimet e orgazmës, ngaqë rëndom kishte urth, më bëhej se ai zuzari kaq vrullshëm po e pomonte, sa do t’ia nxirrte nga goja rropullitë e barkut. Është mashkull i fortë, i fortë dhe i ngrohtë, i kishte mirëbesuar parukieres, pa mundur të përmbahej. Sapo ma rrëfeu këtë pohim Huva Teodor Jakova, e cila si për të ndërmjetësuar midis nesh bënte lojë të dyfishtë, kaq m’u pështiros, sa vura dorë mbi nënën time. E zura nga flokët dhe i dhashë një dackë flakëruese. Mirëpo teksa matesha për të dytën, e ndala dorën. Ndërsa ajo, megjithëse u përlot, nuk bëri asnjë përpjekje për t’u mbrojtur.

- Ia nise edhe ti si yt atë? - vajisi kokën dhimbshëm.

- Pse, ç’bënte im atë?! - iu skërmita.

Për të ma bërë me dije sjelljen arrogante të të shoqit, u mjaftua të thoshte se ai paskësh qenë tip që i thyente arrat me dhëmbë, çka linte të nënkuptohej sa lehtësisht ia thyente turinj të asaj.

- Sarahoshi, - s’e mbajti veten pastaj, - shpirtin ma ka marrë ato vite!

- Kurse ty t’i ka marrë Zoti mendtë, - ia ktheva. - Ti prandaj nuk e di çfarë tipi je vetë, soji i fyryfçkës apo i rospisë.

- S’ka gjë, ti mund të thuash çfarë të duash. Por për mua kjo është dashuria e jetës.

- E ç'dashuri, moj kuçkë, për nga moshja kjo marrëdhënie është incest! - i turfullova i dërrmuar.

Sa më tepër zbrisja drejt fëmijërisë, aq më ndryshe më shfaqej Fjona. Nuk i di të gjitha, përveçse sa më ka treguar vetë. Prej saj e di se, kur na la babai, isha pesëmbëdhjetë muajsh. Ditën që do të vdiste, duke dalë nga shtëpia, i kishte thënë së shoqes, ma vish mirë djalin dhe vëre në zymbyl, se do të vij ta marr për ta shëtitur me veturë. Kushedi ku i kishte dalë përpara Dolores Kamenica dhe ishin nisur drejt fatit të zi. Kurse Fjonës për shumë kohë i mbeti një ngjak i frikshëm. Asaj i dukej se, përderisa babai kishte vendosur të më merrte me vete në ditën funebre, as unë s'e kisha të gjatë. Prandaj, sikur një flamë e zakonshme të më binte, tërë natën më rrinte e alarmuar te koka. Megjithëse edhe vetë shkonte rrallë, fort rrallë, ndoshta kjo ishte arsyeja përse nuk më çonte në varreza, derisa u bëra shtatë vjeç. Mbaj mend se mëngjesin kur shkuam, ngaqë ishte ende herët, dëgjova dikë që po i thoshte një vizitori tjetër: "Të gjallët paskan fjetur me të vdekurit mbrëmë!" Aty mora vesh se ishte dita e Pashkës. Por kujtoj gjithashtu edhe zbritjen, rrugën e tatëpjetë me shitoret e luleve dhe punishtet e varreve anash. Ca tabakë të mëdhenj mermeri po i vendosnin rresht e rresht ndër kambaleca. Faqet e tyre ishin të lëmuara, pllaka gjithë bardhësi, por ca damarë mavi sikur shkruanin në mënyrë të mistershme emrat e të vdekurve të ardhshëm. Meqë kisha kthyer kokën, nëna më tërhoqi

nga dora, duke shpejtuar hapin për t'u larguar, thua se njëri prej të ardhshmëve të isha unë.

Në mbamendjen time ky ka qenë fillimi i fillimit. Më pas priti sa u bëra gjashtëmbëdhjetë vjeç, që të më fliste më hollësisht për të shoqin. Por deri vonë mbeti e mbyllur në vetvete. Ajo ndërroi punë disa herë ndër vite, derisa u bë paketuese në një fabrikë konfeksionesh për eksport. Kaq e kënaqur ishte aty, sa kur Terenc Haskodeci i propozoi që të punësohej në Sallonin e tij, në fillim nuk deshi, vetëm e vetëm për të mos i humbur shoqet. Atë kohë me shoqe e kisha parë gjithnjë. Pastaj, me t'i lidhur telat, diç ndryshoi dhe iu dorëzua si e falisur atij mashkulli.

Në të vërtetë, sinjalet më të hershme të ndryshimit m'i kishte dhënë pasqyra. Fjona nisi të rrinte gjatë para saj, duke e tonuar fytyrën me pudër dhe duke përdorur rimel për sytë. Pak nga pak mësoi cigaren, në muzg zbriste në kafenetë e kompleksit dhe, çmos kurrë më parë, ndonjëherë shkonte edhe në teatër, duke pasur me vete Huva Jakovën si dorëzane faqe të tjerëve. Pastaj e tejkaloi dhe këtë fazë, dilte vetëm me Terencin.

Atë mbrëmje, me një metër shirit në dorë, po maste ca zinxhirë rrobash, që s'dihej qyshkur i kishte ruajtur në një qese. Me gjasë, asnjëri s'e plotësonte gjatësinë që kërkonte, sepse psherëtiu. Kur e pyeta përse psherëtinte, u gjegj vetvetiu por disi kuturù: "S'ka gjë, shumë gjëra të shkurtra ka në këtë botë. Por më e shkurtra është jeta!" Dhe menjëherë i ra një përskuqje. Terenci, fap-fap, luajti qerpikët. Tashmë ata kishin filluar të krijonin edhe gjuhën e tyre të shenjave, atë me gjeste, me sy e qepalla.

Ka qenë pikërisht kjo koha, kur nuk po e merrja vesh se ç'dreqin i fermentonte në trup. Herë-herë, Fjona mbante erën e krundeve të thartuara, çka ndoshta e ndiente edhe vetë, prandaj lahej shpesh. Një pasdite ishte ende me rrobë-dhomën peshqir, siç kishte dalë nga banja, kur u vërsul në ballkon. Unë u habita, ç'donte atë çast aty? Pastaj u kujtova se ishte ankuar për beditjen e milingonave. Fjona donte t'i shfaroste ato miza dhe, sepse kishin arritur deri në raftet ushqimore. E pashë si i ndiqte përgjatë bordurës së ballkonit me një furçë të vogël, që kishte lopatën e vet. Kur zgjaste dorën dhe milingonat shtireshin si të ngordhura, Fjona u fliste me zë, unë s'jam budallaqe, nuk ma hidhni dot! Ndërsa kur i shpëtonin duke u futur nëpër vrima, e dëgjoja si turfullonte dhe, bashkë me insektet, mallkonte veten njëkohësisht. Qysh prej asaj dite, siç ia bëra atë çast duke i trokitur në xham dhe duke i thirrur për së pari, sa herë ma sillte te hunda, do t'i kthehesha: "Vrit miza, mama, vrit miza!"

Ashtu si unë sjelljen e Fjonës ndaj meje, edhe ajo kishte nisur ta vëzhgonte sjelljen time ndaj saj. Prandaj, sapo kapej gafil, bërbeliste buzët dhe ulte qepallat, thua se ishte nisur për diku dhe, gjatë kësaj arratie, nuk donte të shihte askënd përveç Zotit. ("Zot, mos na lësho dore!", e kisha dëgjuar të lutej dikur.) Mirëpo një mendje më thoshte se tashmë, nën trysninë e lidhjes që kishte krijuar, ajo pamja e saj disi e mugët për një femër por gjithherë e sinqertë, kishte mërguar pa kthim. Sa herë të donte, mund ta ndryshonte çehren sipas situatës. Pak nga pak po ia fiksoja trajtat. Por prej zakonit të saj për

t'i ndryshuar shpesh, pyesja veten sa, sa u bënë? Derisa, mbasi e solli të dashurin në shtëpi, u bë e hareshme dhe dinamike. Por në sytë e mi edhe komike, sepse i shtoi bërbelitjet e buzëve. A thua lutej ashtu, pa guxuar të ngrinte zërin? Nëse po, paradoksi i kësaj devotshmërie e tregonte si mëkatoren e mishit në kishë.

I ndodhur në fund të rrugës Dëshmorët e 4 Shkurtit, kompleksi i pallateve s'e kishte larg as Kopshtin Zoologjik. Përgjatë ditës, shpesh, klithjet e kafshëve dhe ulërimat e shtazëve dëgjoheshin deri në apartamentet tona. Nuk mungonin sidomos herët në agim dhe përpara muzgut. Disa thoshin se klithjet e shtuara ishin shenja të sëmundjes, të tjerë flisnin për një trazim misterioz, që s'dihej përse shkaktohej atje. Por njëherë ndodhi një batërdi, që s'kishte të bënte me orën e Zooparkut.

Në mëngjes, kur Fjona doli në sheshpushimin e katit, i tha fqinjës: “Mbrëmë kam parë një ëndërr, një ëndërr që...” Dhe pa mundur ta çonte fjalën deri në fund, ia dha gazit. Duke parë si qeshte ajo, befas, nisi të qeshte edhe fqinja. Pas pak, fqinja takoi në ashensor fqinjë të tjerë, të cilëve u tha: “Mbrëmë Fjona Kokona kishte parë një ëndërr, një ëndërr që...” Dhe pa mundur të jepte asnjë sqarim, ia dha gazit. Duke parë si po qeshte ajo, befas, nisën të qeshnin edhe ata. Deri në mbrëmje lajmi ishte përhapur në të gjithë pallatin, ndërsa pas dy ditëve përfshiu gjithë kompleksin. Në muzg, kur dilnin në ballkonet që shihnin nga oborri i brendshëm, sapo banorët vështronin njëri-tjetrin, i zinte një e qeshur që

s'kishte ndalim. Vala kalonte nga ballkoni në ballkon, nga kati në kat dhe nga pallati në pallat.

Vetëm Sedona Vasia, e harruar në punën e saj, tregonte një asnjësi të pacenueshme. Ajo dilte në ballkon me një pasqyrë në dorë dhe niste të krihej. Atë pasqyrë zonjusha e kishte dhuratë nga e ëma, e cila e kishte blerë në dritë të ditës, në një panair pa çati. Si ishte parë vetë dhe cilësia e qelqit i kishte pëlqyer, ia kishte zgjatur së bijës gjithë bujari. Mirëpo, ende pa e parë asnjëherë fytyrën e saj në pasqyrë, rrugës nga panairi për në shtëpi, Sedona Vasia e kishte humbur nënën nga një arrest kardiak. Prandaj, kur e shihnin në ballkon, disa nuk e përmbanin dyshimin: Kinse krihet, thoshin. Në dritë të ditës, sipas tyre, ajo kërkonte t'i shfaqej në pasqyrë shëmbëllimi i fytyrës së nënës. Megjithatë, herë-herë edhe zonjushën e trazonte vala e qeshjeve dhe, kur i kthente kurrizin oborrit, përkohësisht pasqyra shihte poshtë.

Në krye të javës edhe media shfaqti interes. Të hënën, pas regjimit të Zooparkut, në oborr u panë gazetarë e kameramanë. Por punën më të lodhshme e patën operatorët e zërit që, përveç mikrofonave të dorës, përdorën shtaga e gjirafa. Duke ndenjur në përgjim, sapo ia behën të qeshurat, filluan të incizonin. Nganjëherë u jepnin edhe shenja banorëve për ta shpejtuar ose ngadalësuar ritmin, për ta ngritur ose për ta ulur zërin. Por doli se ky dirigjim ishte i panevojshëm, pasi në atë oborr të mbyllur akustika ishte e jashtëzakonshme.

Unë u gjenda poshtë, i ulur në bordurën e shatërvanit, por të gjithë sa ishin nëpër kafene e shitore, dolën jashtë.

Risto Saraçi, një solist i Teatrit të Operës, doli nga Bar Adoro me krikllën e birrës në dorë. Për Riston thuhej se, qëkur e kishin nxjerrë në pension të parakohshëm, duke u dhënë pas pijes së tepërt, po letohej disi edhe nga trutë. Kaq fort e tundi kokën solisti, sa nga shkundullima u duk se flokët e grinjtë do t'i binin në tokë njëherësh, si të ishin flokatë skene. Në të vërtetë, atë po e tërbonin stonaturat në korin e hargalisjeve dhe, prej acarimit nervor, iu drejtua gaztorëve për t'i ndalur:

“Mjaft pra! A e dini kur është boll?!” Dhe meqë ata nuk u ndalën, vazhdoi: “Qeshni, maskarenj, qeshni! Ju keni të drejtë, horrat e përdorin të qeshurën si shami për lotët.”

Ndoshta me këto fjalë arriti të lante gojën, por të shpëlante edhe mustaqet që ia mbuloi shkuma, teksa zbrazte gotën e birrës. Sakaq, me të nxjerrë jashtë atë gjuhën e madhe, që të shtinte ndër mend fletën e ventilatorit, nisi të lëpihej lart e poshtë buzëve. Pastaj bëri edhe një përpjekje, duke i paralajmëruar gaztorët, por pa sukses:

“Qeshni, o dritëshkurtër, dhituni gazit. Por nëse nesër do të qani, unë nuk mbaj përgjegjësi.” Dhe si e hoqi përgjegjësinë nga vetja, m’u kthye mua: “Di gjë, e ka edhe ndonjë gjuhë tjetër, apo shprehja *U dhjeva gazit* thuhet vetëm në gjuhën tonë? Se këta të lafitur atë punë po bëjnë, po mbushin brekët. Ç’e kanë këtë trazim, or Qazim?”

“Nuk më quajnë Qazim”, thashë.

“S’e kam me ty, e kam me atë prapa teje.”

“Mua më quajnë Naim”, tha i biri i Huva Jakovës, duke e mbajtur lart njërën vetull, si ta fiksonte me kapëse.

E qeshura është lakrimogjene si qepa, prandaj s’u çudita kur pashë lot në sytë e disave, teksa publikun e oborrit po e përfshinte dalldia me: Ha-ha-haaa e Hi-hi-hiii! Madje, në një hop, edhe mua m’u ngjit. Për shkak të mishit në hundë, zëri më doli si mitraloz i ngjirur. Sidoqoftë, e mblodha veten shpejt. Ndërsa për të tjerët unë nuk mund të thosha përse qeshnin, sepse s’kishte ndonjë shkak të dukshëm, prandaj më vinte të çmendesha.

Atëherë, duke hamendësuar gjithfarë shkaqesh, më vajtën sytë në katin ku banoja. Çifti Terenc & Fjona kishte dalë në ballkon dhe, ndoshta, të nxitur nga ajo ëndrra enigmë, shumëkush andej po vështronte. Atëherë dyshova se kallaballëku po qeshte nën efektin e kontrastit, dallimit komik mes Romeos së ri dhe Xhuljetës nënole. Por dyshja e ballkonit nuk e përjetonte aktin si unë, ata po gajaseshin njëlloj si berihaja. “Atëherë e paskan me mua”, m’u ngjall një dyshim. “Patjetër me mua po tallen. Ata habiten me nënshtrimin tim. Në sytë e tyre unë jam qyqani, qyqani që e ka pranuar jaranin e nënës në shtëpi si kollovar. Pse jo, ndokush mund ta ketë dëgjuar edhe *laleshën* duke kënduar për *lalin*.”

Një ditë më parë, mu në oborrin e brendshëm, kur po dilte nga Salloni Mix Fa dhe dikush ia kishte hedhur një thumb, Fjona Kokona ia kishte kthyer pa gajle, duke ndërfitur për erëza pak italishte televizive: “Po, zotëri, *vicini-vicini* jetojmë. Ai është dashuria e jetës sime dhe,

siç më ka shpirt e yll, xhan e zemër e kam. Tani leh sa të duash gam-gam!”

Shatërvani ishte në mes të oborrit, prandaj dhe unë në qendër të ciklonit. Por sado u tërhoqa mënjanë, nuk shpëtova nga rrebeshi. Veçse nganjëherë edhe për mua e qeshura e humbiste kuptimin. Nuk shprehte më as fshikullim, as ngazëllim, as argëtim. Prandaj m'u rikthye pyetja, po këtyre idiotëve ç'u ka hipur në kokë?! Aq më tepër që, ngase ishte prishur regjimi i Zooparkut, në atë orë të pazakontë po dëgjoheshin angullima, hungërima e sokëllima, pëllitje, krrokatje, blegërima, piskama e bulërima, hamullitje, kukullima, buhatje e ulërima, shkrofëtima, rrapëllima, vringëllima dhe përsëri qeshje, përqeshje, nënqeshje e ngërdheshje... Më zuri një dhimbje mbytëse në grykë dhe ia dhashë vrapit në krahun e kolonave, nga ishte dalja në rrugë.

Nga prania e gazetarëve, banorët pandehën se për të qeshurën e tyre do të jepej ndonjë lajm në revistat televizive. Por as të nesërmen, as të pasnesërmen, në asnjë edicion nuk u dha. Dy kronistë që kishin mundur të zbulonin fillin nismëtar të lëmshit dhe kontaktuan me Fjonën, thanë se ajo ishte një llasticë, në mos një budallaçkë sklerotike, sepse pyetjes se çfarë kishte parë në ëndërr, i qe përgjigjur: “Tani nuk më kujtohet, por atë dua të di edhe unë. Pyesni zonjushat e tjera të pallatit se mos ndonjëra ka parë ëndrrën time. Ah, çfarë fanitje m'u shfaq, ishte një ëndërr që...” Dhe pa shtuar asnjë fjalë, ia kishte shkrepur gazit para gazetarëve.

Sidoqoftë, hargalisjet kolektive nuk shkuan dëm. Sa herë që në kanale të ndryshme jepej ndonjë emision i

karakterit të humorit, në kolonën zanore dëgjoheshin të qeshura të furishme, madje edhe të vetvetishme e të shëndetshme. Veçse nuk ishin *live*, ishin nga ato të arkivit, që përdoreshin për t'ua ngjitur të qeshurën edhe teleshikuesve. Qysh prej asaj kohe, ndërsa në Tv qeshej, gjatë tërë kohës së transmetimit banorët e kompleksit tonë rrinin me veshët ngrehur, duke u përpjekur të njihnin ndonjë zë. Dhe kur ndokush arrinte ta dallonte zërin e vet, brofte më këmbë për t'i dalë zot dhe për ta shpërndarë lajmin nga dritarja:

“Mbani vesh, jam unë, unë jam duke qeshur tani. Mos e harroni këtë kumbim, është floriri i zërit tim!”

- Ti, ti... ti! - nisi të thoshte Fjona, duke më shenjuar me gisht, thua se nuk kishte një por nja dhjetë djem të barkut, prej të cilëve donte të më veçonte mua. - Ti e pate fajin, - i vinte vulën pastaj, sa herë bëja sherr me kollovarin.

Megjithëse Terenci nuk ia përkrahte këtë ndarje, madje për të ma bërë qejfin, nganjëherë e merrte përsipër fajin vetë, sherri do të përsëritej shpejt për çfarëdo dhe kurdo. Ato kohë kisha humbur edhe punën, çka e mahisi më tepër acarimin tim. Për një vit kisha punuar në një fabrikë të përpunimit të mishit, i ngujuar te makina që mbushte salsicet. Më pas në një agjenci turistike, si i përkohshëm në sezonin e verës. Vetëm në picerinë Oreksi, që gjendej pranë stacionit të dikurshëm të trenit, shpresova për punë afatgjatë. Mirëpo lokali u

shemb për nevoja urbane të qytetit. Nga dëmshpërblimi që iu dha, pronari më daroviti me katër paga bonus. Unë pikërisht me këto të holla po kullandrissha, por ama duke shtrënguar dorën.

Gjatë ditës, me një hamburger në vaktin e drekës, Biblioteka Kombëtare u bë shtëpia ime. Kisha disa shtysa që u dhashë pas leximeve, duke ripërtërirë zakonet kur isha student. E para ishte nevoja për t'u gjendur sa më pak atje ku më zihej fryma, në apartamentin e zaptuar tashmë. E dyta, përballja me zvetënimin që vjen nga boshllëku. Kjo ka qenë edhe koha kur kërkova rrënjët e tim eti dhe, i shtyrë nga origjina e tij malësore, lexova me shënime Kanunin e Lekë Dukagjinit. Por pa shkëlur më nëpër diskoteka, pa ndonjë gotë te zona e Bllokut, shkurt, pa mundësi financiare për të ndjekur jetën që bënin shokët e mi, filloi ftohja mes nesh. Tashmë fare rrallë më binte telefoni, madje të rralla u bënë edhe klikimet në Facebook. Kështu, pak nga pak ndjeva një kërcënim të ri, m'u duk vetja si i përjashtuar nga rrethi shoqëror. Ndërsa ditët e fundit, teksa bëja ca lidhje që më parë s'më kishin shkuar ndër mend, po e zgjeroja këtë rreth.

Verës, kur punova në atë agjencinë, për gjashtë ditë shoqërova në Malësinë e Madhe ca turistë çekë. Me atë rast u vura në kërkim të prejardhjes së tim eti dhe të fisit të tij. Në Tamarë gjeta një plak me mbiemrin Labora, prej të cilit mësova diçka për Lisin e Gjakut. Po bisedonim ndanë lumit të Cemit, kur plaku bëri një betim shafitës: "Pasha këtë ujë që lan të gjallë e të vdekun, një fjalë s'e ke rrenë prej meje! Veçse bane vetë hesapin, po të kallëzoi çka kam ndigjue, jo çka kam pa me sytë e mi."

Fisi ynë dikur ishte ndarë në dy degë. Babai i përkiste degës së vogël. Një paraardhës i largët, i quajtur Preng Mark Labora, ishte kapur natën teksa dilte nga kisha, ku kishte vjedhur një ikonë. S'e donte shkretani as për shtëpinë e vet, as për ta shitur. Një udhëtar i huaj kishte gjetur strehë te Prenga prej dy javësh. Meqë në mëngjes do të largohej dhe meqë të zotit të shtëpisë nuk i ndodhej ndonjë shenjë e çmueshme për t'ia dhuruar mikut të largët, ishte kujtuar t'i falte Jezus Krishtin e kishës. Në bazë të Kanunit, katundi e ndëshkoi rëndë, duke e shpallur *gjakhupës*, çka e ekspozonte edhe ndaj vdekjes. Tani kushdo mund ta vriste lehtësisht, sepse asnjë nga familjarët dhe askush nga fisi i tij nuk ia merrte gjakun. Me këtë status, ky gjakhupës u bë një *i përjashtuar*. (Në leximet e mëvonshme do të gjeja se Giorgio Gamba e përfronte gjakhupësin me homo-sacer.) Por Preng Labora nuk deshë të vdiste. I ndjekur nga pak të afërm, e lëshoi malësinë dhe zbriti në qytetin e Shkodrës. Pasi u ndërruan brezat, njëri nga pasardhësit e la Shkodrën për Tiranën. Ai hyri në kryeqytet me cigaren në buzë, filizin e borzilokut në vesh dhe ca specë me djegësirë të fortë në hejbe. Pikërisht ky pinjoll i një të përjashtuari do të bëhej stërgjyshi i një të përjashtuari tjetër, David Jakin Laborës, sepse tashmë i tillë kishte nisur të më ngjante edhe babai. Kur shkeli kurorën duke rënë në greminë me dashnoren, kushedi përse, Fjona nuk njoftoi për mortin askënd nga fisi i tij. (Mos ka qenë ky çasti i vendimit për ta lëshuar mbiemrin e burrit dhe për t'iu kthyer mbiemrit të vet?!) Pastaj, siç e nxori nga shtëpia me arkën e mbyllur, e nxori zgubthi edhe nga zemra.

Sado që mua nuk ma tjetërsonte dot mbiemrin, kujtimin e tij e përjashtoi nga familja.

Por në bibliotekë po më dilte përpara një pyetje paralele: Mos vallë, pak nga pak, po përjashtohesha edhe unë nga ajo shtëpi?

Ndodhte që ai birboja, i lodhur nga punët e ditës, mbrëmave shkonte të shtrihej më përpara. Ishte një lajm se edhe unë do të flija pa spica në kokë. Por s'e duroja Fjonën kur në raste të tilla, me atë llastimin e italishtes televizive, nisi t'i thoshte: "Sogni d'oro, tesoro!" Doja a s'doja unë, një lumë fjalësh therëse më vërshonin përbrenda, lapërdhare, rospi, kromë e vromë, kuçkë, piciferrë, zuzare e rezile, ke rënë në marrosje verbane, stërvinë! Si t'ua dëgjonte tingëllimën prej ndonjë misteri, teksa më vështronte me bisht të syrit, Fjonën e kaplonin ca turbullime ligështuese dhe në fytyrë i lexohej një klithmë e shurdhët. S'e di nëse bënte gjyq me veten apo me mua. Njëherë më tha: "Ka me të vra ahti im!" Madje guxoi edhe të më nëmte: "Të marroftë Perëndia ty, që thyen zemrën e nënës! Zoti pafhtë e pagoftë!" Por më shpesh vetëm bërbëliste me njëfarë shkrumbi në gojë. E merrja me mend, ishte Lutja e Buzëve. Liania e pazëshme që, duke qenë e sipërfaqshme, thuhet se nuk arrin te Zoti, sepse buzët vërtet lëvizin, por mendja dhe zemra flenë.

Më pas sikur i iku gjuha. Pa pranuar më asnjë shqyrtim me mua, filloi të fliste shkurt, si me fjalor ushtarak. Në vend të "Gatitu!", unë nënkuptoja: "Rri urtë!" ose "Qepe gojën!" Ndërsa komandën "Para marsh!" e zëvendësoi me: "A merr vesh, shih përpara!"

Çfarë kishte parasysh me këtë urdhrin e perspektivës? Sepse unë s'shijja të ndryshonte diçka, përpara gjeja çfarë kisha lënë mbrapa. Prandaj nga urdhri nënkuptoja: Ose të pajtohesh me rrethanat, ose t'ia mbathja nga shtëpia. Ndoshta edhe ajo, edhe unë, e kishim humbur përgjithmonë impulsin e ngrohtësisë natyrale, që ka marrëdhënia nënë e bir.

Në këtë pikë isha unë që bëja gjyq me veten. Mos po gabohesha? Mos i kisha ndërsyer grindjet vetë, për t'i hapur rrugën ndarjes përfundimtare? I qe rënduar nënës i biri apo të birit e ëma?.. S'më shqitej nga mendja mbrojtja e saj atë ditë, kur solli dashnorin në shtëpi. "E ç'dashke më tepër prej meje, nuk të mjafton që sakrifikova rininë për ty?! Një copë mishi me dy sy ke qenë, kaq të la yt atë. Por unë e lidha jetën me zotrote, unë të ushqeva, unë të rrita, unë të shkollova. Dhe gjithnjë e vetme, krejt fillikat, pa burrin në krah dhe pa ndonjë njerë për mbështetjen e kalamanit." Veçse nuk vazhdoi më tej për ta shkoqitur se si do të sillej ky njerku, do ta birësonte jetimin me të gjitha detyrimet, apo do t'i jepte dajak dhe, si maniak, do ta ngacmonte seksualisht.

Gjithsesi, sipas saj, kishte ardhur koha që ndonëse me aq vonesë, ta pranoja njerkun tim. Mirëpo ne, dy meshkujt, nuk e prananim instinktivisht njëri-tjetrin. Vetëm dy vjet më i madh se unë dhe ai këlysh bushtre mëtonte të bëhej *babai* im. Ptu, ptu! Unë prandaj e shijja si incest edhe marrëdhënien e tyre. Prandaj s'më pushonte goja me Fjonën, duke i vënë Terencit gjithfarë epitetesh. Nga skuthi e skilipeci, kisha kaluar

te dordoleci, nga dordoleci te burreci dhe, për ta bërë hiçmosgjë, arrita te karkaleci dhe buburreci. Vrit miza, mama, vrit miza!..

Mirëpo, në të vërtetë, ai ishte skile. S'kam hasur kurrkund njeri më abraziv. Mjaft të ndodheshim bashkë dhe ndieja si gërryhesha përbrenda nga gjendja që krijohej. Sidomos pas ditës kur ia pashë kartën e identitetit. E kishte harruar në tryezë dhe më gjeti të kërrusur mbi atë kartë, thua se nuk ma kapnin sytë me një lexim, por më duheshin tre a katër për të perceptuar morinë e shkronjave: Terenc Ferdinand Haskodeci.

Bash atë çast ma parashtrroi traktatin e tij të paqes. Jeto dhe na lër të jetojmë, më tha. Por unë tashmë i kisha ende nervat e nxehta. Me atë emër aq të gjatë, m'u tipos se ai do të ishte i përjetshëm në shtëpinë tonë, ndërsa unë do të vdisja shpejt nga konfliktet dhe mërzia.

Një mbrëmje, teksa po kaloja në korridor, Terenc Ferdinand Haskodeci u ndodh pas meje. E çfarë s'mund të presësh, kur njerkun e ke bashkëmoshatar?! Duke dashur të bënte shaka, befas më futi stërkëmbësin dhe kur u qorrollepa deri te dera me njërin gju në dysheme, përveç tij qeshi edhe Fjona Kokona. Pastaj, ndërsa shihte si po më ndryshonte fytyra nga inati, nxitoi ta shuante sherrin sa pa nisur: "Asgjë, Martin, një çapkëllëk ishte. Pak akull në gju dhe kalon. Duket sheshit se në kockë nuk pësove gjë prej gjëje." Ah, moj pilivrickë, fyçkë e fyryfyçkë, palca ime e di sa dhembti prej marrëzisë së tij, por sidomos prej anësisë sate!

Si kaluan pak ditë, po në orët e mbrëmjes, çapkëni i Fjonës e përsëriti trillin. Isha ulur në divan dhe po ndiqja një emision, kur ndjeva nga mbrapa të m'i hidhte duart rreth qafës. "E sheh çfarë mund të të bëj?! - foli me ton hokatari. - Po të shtrëngova edhe pak, ta nxjerr nga goja arrëzën e fytit." Nënteksti më erdhi si paralajmërim: Herë tjetër mos llap, zullap!

Përse nisën të më gjëmonin veshët ato çaste? Përse më bëhej sikur dëgjoja një breshëri automatiku? Mos kishte ardhur ora të flisja me Maznik Krisilin? Ai me Ortakun, Ortaku me dorasin dhe dorasi pastaj... Ç'të bëja tani me këtë hundëmadhin, të cilin e rrente mendja se në atë pozicion ishte i mbrojtur? Ta zija për feçke dhe t'ia tundulloja hundën, derisa t'i thërrmoheshin kërcet?

E zgjidha ndryshe ngërçin. Ia hodha krahët kular në zverk dhe zura ta tërhiqja drejt parzmit tim. Kur iu var koka më poshtë se parzmi dhe trupi i tij i lehtë po shkëputej nga dyshemeja, arrita të ngrihesha. Pastaj, me ta përfshirë në bel, ashtu siç ishte me kokën teposhtë dhe këmbët përprjetë, e përplasa në divan. Teksa mblidhte duart në stomak, aty ku e kisha shtrënguar, rënkoi gjithë ankim:

- Ma more frymën, desh më mbyte, idiot!

- Ajo e para ka qenë lojë, - i kujtova stërkëmbësin në korridor. - Kjo ishte ndeshje në tapet. Dhe që të mos mblidhesh më gërmuq, bën mirë të mos e harrosh këtë tuç!

Fjona po më shihte e shtangur. Goja i kishte mbetur gjysmë e hapur, thua se do të vinte kujën.

- Pse sillesh si halabak?! - m'u turr helm e vrer.
Pastaj i dha vetes disa sekonda, derisa të fshinte lotët.
- Ta duash Terencin! Ta duash, po të them, ju jeni si
vëllezër.

Meqë vetë i rrëshqiti goja, ia ktheva aty për aty:

- Atëherë pranoje pra, ti bën incest!

Nuk kam më mëdyshje, ky ka qenë rasti që e damkosa
me mëkatin kriminal. Veçse pa më shkuar mendja deri
në ç'shikallë mizore do të më rrënjojej tmerri i incestit,
kur të isha larg.

Pas asaj dite, sapo më shihte, rrallë e shkrehte
fytyrën nga shtrëngimi i muskujve. Fjona i ngriu
marrëdhëniet me mua. Kurse ai ndoqi taktikën hiq e
mos e këput. Madje, pa u mbushur java, më dha shanse
për punë nëpërmjet një kushëriri të tij, por nuk pranova.
Pastaj, meqë vetë kishte edhe dy magazina ku shitej me
shumicë, më propozoi të bëja menaxherin e tyre. Do të
udhëtosh shpesh, më siguroi, sidomos në Turqi dhe në
Kinë. Përsëri nuk pranova. Ato të holla m'u dukën të
pista, si të isha tutori i nënës sime dhe ai të më paguante
për laviren që shkërdhente. Në vend të më zbuste
ndopak, qëndrimi i tij i dyfishtë, miklues dhe hipokrit,
ma shtoi zemërimin.

Kisha vënë re se Terenc Haskodeci hidhërohej më
tepër kur humbte diçka, sesa gëzohej kur e fitonte.
Përkundrazi, tani që kruanim brirët për nënën time,
dukej sikur ishte i gatshëm që, për të triumfuar ndaj
meje, t'i humbiste të gjitha dhe të mbante Fjonën. Më
kishte mposhtur, me një fjalë. Kot ia dridhja vetes,
përderisa edhe Fjona mbante krahun e tij, ndërsa unë

e kisha përjashtuar propozimin për qërim hesapesh, që ma kishte bërë Maznik Krisili. (Po përse vazhdonte të më gjëmonte truri nganjëherë?!) Në këto rrethana vetëm një shteg më mbetej, arratia nga shtëpia. Nuk mbaj mend t'ia kem thënë hapur, por besoja se e kishte nuhatur. Heshtja e saj sikur thoshte, mos iksh kurrë, por edhe mos u kthefsh kurrë!

Shansi im që, tamam në këtë pisk të fatit, dikush më telefonoi nga Italia. Ishte Roni, bashkëstudenti i dikurshëm, i biri i Maznikut. Pas vizitës në vilë, i ati e kishte njoftuar për mua dhe Roni nuk po më telefononte për t'ma qarë hallin. (Më vjen çudi si paske mbetur ende me atë motor rrangallë dhe si e duron atë pushtin në të gjallë!) Miku i ngushtë po më ftonte atje, ku prej vitesh jetonte vetë. Donte adresën time elektronike për të më nisur garancinë dhe biletën e avionit.

Aneks

a) Do ta kuptoja atje përse Roni Krisili, i cili në bazë të dokumenteve italiane quhej Edmond Kristo, më kishte lënë në harresë ato vite. Nuk më kishte telefonuar, për të mos më joshur në rrugën ku kishte hyrë vetë. Edhe të ëmën e motrën e tij, sado që i kishte tërhequr prej kohësh në Itali, i kishte sistemuar më në veri, në një tjetër vendbanim dhe i takonte rrallë, gjithmonë si rastësisht në ndonjë adresë të tretë.

Mua më vuri të banoja në katin e dytë të një ndërtese, që ia kishte blerë një torinezi, i cili në kushte të ngutshme për t'u kthyer në qytetin e vet, e kishte shitur me çmim të arsyeshëm. Në fillim më bëri përshtypje theksimi i këshillës për grilat e dritareve. Unë shihja me habi se si, ndaj të mugëtit, në të gjitha shtëpitë mbylleshin grilat dhe shumica ishin të llojit taparela, kapakë dërrase që s'linin të hynte një pikë drite. Me gjasë, unë figuroja si qiraxhi i signor Kristos, sepse më pajisi me kontratë noteriale dhe, në krye të dy muajve, më udhëzoi të paguaja qiranë

me veprime bankare. I derdha të hollat në numrin e tij dhe, sigurisht, nga xhepi i tij. Vetëm shtatë muaj më pas ma dha në dorë lejeqëndrimin (permesso di soggiorno) zyrtar, që nuk e mora vesh me çfarë lidhjesh e siguroi në kuesturë. Për çfarë ishim marrë vesh më parë, ishte identiteti im.

Kur linda unë, babai kishte dëshiruar të quhesha Marian. Por kumbari, një kolegu i tij kamionist, ngaqë s'e dëgjoi mirë apo ngaqë kishte vetë një mbesë me emrin Mariana, më pagëzoi Martin. Edmond Kristo, me miratimin tim, nga Martin Labora ma ndryshoi identitetin në Marian Miromara. Si i erdhi në mend ky mbiemër, vetëm ai e di. Por parashikoi me saktësi si do të thirresha nga të tjerët. Sidomos për femrat, tha ai, ti do të jesh Mario. Apo s'je dhe simpatik, i hedh femrat në fik!

b) Në Tamarë, buzë lumit të Cemit, e pata shuar kërsërinë për mbiemrin që trashëgoja nga im atë. Mos me ta marrë mendja, vinte nga një rrasë malore. Gjatë verës dhe vjeshtës ky gur ndërronte ngjyrë, bëhej i hirtë e madje vinte ca si njolla ndryshku. Dimrit nuk shihej më, kurse në pranverë dilte krejt i bardhë, se e *lante bora*. Rrasën e madhe fisi i babait e kishte në kullotat e veta, prandaj ata njerëz prej saj e morën mbiemrin: lan bora = Labora.

c) Unë nuk ia hapa, por as miku im s'e ceku bisedën për vilën e tyre. (Do të më ruante edhe në të ardhmen prej çdo gjëje që e mendonte ose të rrezikshme, ose si

të padenjë për mua.) Historinë e saj ma kishte rrëfyer i ati gjatë darkës. Shtëpia e tyre përdhese kishte pasur një truall të ngushtë, prandaj për vilën kërkohet zgjerim nga të dy krahët. Me fqinjën nga e majta u morën vesh shpejt, ai ua shiti truallin. Megjithëse ia rritën çmimin tri herë, pronari nga e djathta s'e lëshonte tokën kurrsesi. Kur u ftua për bisedën e katërt, përkrah Maznikut u gjend edhe Ortaku i tij. Kishte ardhur aty me një thes, që ia kishte lidhur grykën pak mbi gjysmën, si të donte t'i thoshte atij kokëforti: E di ç'ke tani? Tani merri këto lingota ari dhe tokës, ku po shkelim, jepi lamtumirën! Por i la kundërshtarët të haheshin me fjalë, derisa fshatari ngulmoi: "Unë vdes dhe tokën nuk e shes!"

Mbas këtij caku të skajshëm, Maznik Krisili dha shenja dobësie, aq sa u duk se po tërhiqej. Por pikërisht atë çast Ortaku hapi thesin. Nxori prej aty dy karikatorë njëherësh, njëriën ia vuri armës, tjetrën e mbajti të gatshme ndër dhëmbë. Pastaj ia uli grykën kallashit dhe nisi të shtinte në ecje e sipër, pa e hequr gishtin nga këmbëza. Me breshëri të gjata, teksa plumbat nguleshin thellë në tokën e butë, i hoqi një tegel cep më cep pjesës që kërkohet për vilën. Që sot e tutje, e paralajmëroi tjetrin, mos guxo ta shkelësh këtë vijë zjarri, ky është kufiri yt! Por as pordhacët nuk i honeps. Prandaj edhe ti, iu kthye si i çakërditur Maznikut, po nuk e bëre konakun këtu, prej dorës sime do të vdesësh.

Dhe vila trekatëshe u ngrit në B.

d) Toponimi B. mund të lexohet si Bërzhitë, Brar, Bërxull, Babrru, Bubeq, etj. Mirëpo, përderisa ngjarjet

zhvillohen në Tiranë, nuk mund të lexohet Bushat, Barbullush, Bëltojë, Bardhaj, Bahçallëk etj., që ndodhën ndanë Shkodrës. Aq më pak B. mund të lexohet si Bolzano, Bari, Bolonja etj., megjithëse i biri i Maznikut, signor Edmond Kristo, i ka shëtitur me pëllëmbë këto vende.

Zaptimi i truallit u bë (pa pasoja të tjera) më 1997, ndërsa pas dy vjetësh vila ishte më këmbë. O Zot, si kokolepset fati i njeriut, e kujt mund t'i shkonte në mend se një ditë edhe unë do të bëhesha me vilë?!

Sa për Ortakun, as mos më pyesni ndopak, atij kurrë s'ia mësova emrin.

f) Përveçse buzë Cemit nga ai plaku, betimin e çuditshëm “Pasha këtë ujë, që lan të gjallë e të vdekun!” e kam hasur gjithashtu në “Hulumtime për traditën zakonore nga Traboini në Vermosh”, faqe 193. Autori i librit është Prof. Augustin Tereku.

Por, pak nga pak, do të mendoja ndryshe për pafuqinë e ujit, të paktën përballë të gjallëve.

Mynxyra dhe balona me fytyra

Për t'u krijuar ngjarjeve një rend, pasi e ndiej se më vijnë rrëmujë, tash po përdor një elips filmash, kur mbasi shihet si mbyllet diku një derë, duke e lënë jashtë udhëtimin me avion, në sekuencën pasuese hapet gjetkë një tjetër. Përfytyrojeni lëvizjen time në kahje të kundërt, jam duke mbyllur përkohësisht derën që më priti në Itali dhe duke hapur atë të vilës sime në Shqipëri. E di se kështu mbesin jashtë shumë vite të jetës, sepse kur kapërceva detin s'i kisha mbushur ende njëzet e katër, ndërsa tani jam tridhjetë e shtatë vjeç. Por, pa e shmangur thelbin, kam arsye të përmbahem në hollësira. Për këtë shtëpi, e cila u ble e mobiluar siç ishte, mund të kem paguar vetëm gjysmën e vlerës. Nuk e di nëse gjysma tjetër ka qenë dhurata e fundit për miqësinë, apo shuku për ta mbyllur gojën deri në varr. Vila ndodhet në gjunjët e kodrës dhe ka rrafshinë përpara. Nga veranda e lindjes shfaqet autostrada me panoramën, që tashmë

njihet si United Cities of TD. Atë mëngjes, në mes Tiranës dhe Durrësit, në kryeqytet po shkoja. Dhe ja çfarë ndodhi.

Kisha kryer punë në bankë, kisha pirë kafe në Sky Tower dhe po i afrohesha makinës aty pranë, kur dëgjoja ca thirrje që u ndërkallën për shkak të erës:

- U hodh, u hodh!

- E hodhën, e hodhën!

Kush ishte hedhur apo e kishin hedhur? Nga po binte? Sipas vështrimit të njerëzve në rrugë, hedhja ishte bërë nga çatia e kullës. Rastet e vetëvrasjeve ishin shtuar tashmë, edhe pse trampolinat e vdekjes ishin ndarë, zakonisht femrat përdornin tarracat, meshkujt krahët e vinçave. Ndarja, kushedi përse, kishte ndodhur qysh në fillim, kur dikush i dha fund jetës nga një shumëkatësh tjetër. Në tarracë u gjet një shapkë me kordele mëndafshi, prova që e përcaktoi seksin menjëherë. Ishte një studente, që as e kishte lënë i dashuri dhe as kishte mbetur shtatzënë me të atin, por ishte rrëzuar përfundimisht në provimet përsëritëse të sezonit. Se përse ishte veshur me petka aq të hijshme për mort, mbeti mister.

Ndonëse kaloi një minutë, në fasadën nga rruga s'ndodhi ndonjë përplasje fatale në trotuar. Ose fatkeqja po e vononte rënien, duke kundruar nga lartësia peizazhin që s'do ta shihte kurrë më, ose rënia kishte ndodhur në anën e pasme të kullës. Cila mund të ishte zonjusha apo zonja? Në rrugë po bëheshin gjithfarë hipotezash, duke përmendur gjithfarë emrash. Nëse është zonja Çela, tha

një kalimtar, me siguri e ka prej sëmundjes së padëgjuar kurrkund. Qëkurse i ka vdekur djali, asaj i dhembin flokët e kresë. Por disa ia kundërshtuan hamendësimin. Është e vërtetë, thanë ata, se Zoti ia ka marrë të birin, por ia ka lënë mendtë e kresë. Sa për sëmundjen, shtoi një fqinja e saj, përveç flokëve, zonzës i dhembin edhe thonjtë e duarve. S'ka ilaçe që mund t'i japin paqe.

Kurse unë u ndjeva i sigurt për nënën time. Fjona Kokona, e cila gjithashtu kishte mbetur pa të birin, nuk ndërmernte kuturisje të tilla vrastare. Ndeza radion e makinës dhe, sapo kalova kryqëzimin e Zogut të Zi, ndera veshët për lajme. Ende s'po dëgjohej ndonjë gazetar i terrenit. Në stacionin ku e prisja lajmin, transmetohej muzikë. Por nga uturima e erës vala vinte me frusho. Sidoqoftë, s'mbeta pa gjë në Vorë, ku e mbajta makinën për kureshtje. Me sytë për hava, disa vendas po ndiqnin me gisht një pikë në qiell, e cila herë afrohej duke u zmadhuar, herë largohej duke u zvogëluar. Madje, në çastin që humbiste nga sytë, shpërthenin psherëtima, bah, uh, ah! Dhe prapë sytë përpjetë.

Në karrocerinë e një kamionçine, si të ishte tribunë e improvizuar, një aktiviste e Shoqatës së Grave Fluturuese bënte thirrje me megafon, vini re, vini re! Me gjasë kishte diçka për të sqaruar. Por moria e njerëzve, që vinte duke u rritur, ia kishte kthyer shpinën për të ndjekur objektin fluturues, atë që disa i mbushte me shpresë, disave u jepte ankth.

“Ç’ mund të jetë kjo gjëja, që endet nëpër qiell?”

Pyetja më drejtohej mua, por unë s’kisha përgjigje. Ndërsa dikush tjetër tha: Zoti e di nëse dhurata është nisur kastile për qytetin tonë, apo vjen pa caktim, të bjerë ku të bjerë. Lum ata që kanë fatin për ta marrë!

Pak nga pak, turma po ndahej për nga prirja, por edhe grupimet kishin kundërshtime ndër veti. Ato i përçante hamendja nëse ishte nisur nga brenda apo jashtë kufijve të vendit. Kishin qarkulluar fjalë se Shqipërisë do t’i vinte një dhuratë e posaçme nga OKB, me motivacionin si demokraci reformatore, ose si faktor stabiliteti në rajon. Për grupin e optimistëve lokalë dhuratën do ta merrte bashkia e Vorës, pasi kështu ishte taksur. Kurse fraksioni i dyshimtarëve, duke medituuar ndryshe, filloi ta humbiste shpresën. Dhurata nuk vinte nga OKB-ja, por nga dinastia amerikane e Bushëve dhe atë do ta merrte patjetër bashkia e Fushë-Krujës, si kujtim për mikpritjen e Xhorxhit gjatë vizitës historike. Pika e nisjes nuk përbënte problem, për arsye taktike ajo mund të ishte edhe e brendshme. Prandaj kini durim, o të mjerë, nga çasti në çast diku do të bjerë!

“Një mut do të bjerë ndonjë dhuratë nga qielli. Vetëm dora e Zotit mund të hedhë mana prej andej”, s’u përmbajt një gjahtar, që po përdorte tejqyrën për vrojtim. “Ju i keni apo s’i keni sytë në ballë?! Një figurë njerëzore është, shihjani fustanin, ia ka hapur era rrumbullak si parashutë. Edhe flokët në erë i ka, të shpërndarë e të hallakatur.”

Si vrojtues i regjur, ai shfaqti bindjen se duke dashur të vriste veten, ndonjë zonjë ishte hedhur nga tarraca, por s'mund ta përcaktonte drejtimin prej nga po e sillnin korrentet e lartësive.

U largova pa dëgjuar çfarë do të kumtonte aktivistja me megafon. Por kisha shanse që, para se të mbërija në vilë, t'i takoja diku shoqet e saj. Dhe i gjeta vërtet në balodromin, ku i kisha takuar herë tjetër. Balodromi ishte rrafshina në këmbët e kodrave dhe, siç e tregon emri, atje lëshoheshin balona. Por s'kishte rastisur ditë e mbarë.

Albulena Polena, kryetarja e Shoqatës së Grave Fluturuese, më pyeti nëse e kisha mësuar lajmin. I thashë se isha ndodhur te kulla njëkohshëm me ngjarjen, por të vërtetën sapo e kisha dëgjuar në radio. Asaj s'i kishte pëlqyer fakti që, në fillim, njerëzit ishin marrë gjatë me emrin e të vetëvrarës. Disa thoshin se quhej Xhilda e disa Brunilda, disa Miranda e disa Eranda. Doli se quhej krejt ndryshe, Laura Sallabanda. Doli se nuk ishte zonjë por zonjushë. Thikë me dy tehe që, ktheje nga të duash, presin njëlloj. Apo jo? Po, iu gjegja Albulenës. Si puna e regjisorit me skenaristin, vazhdoi ajo, s'ke si t'ua ndash fajësinë. Ua ndanë dot, Martin? Unë vetëm ngrita supet, ndërsa asaj po i vrenjtej fytyra. Një gjë s'e marr vesh, përse nëpërkëmben kështu vlerat e jetës dhe përse modeli fatal duhet të jetë një femër, gjithnjë një femër. Ma shkoqit dot, Martin?

Tani që kisha mësuar çfarë kishte ndodhur te kulla, unë s'kisha çfarë të shkoqisja. Atje po xhirohej një

film dramatik, protagoniste e të cilit ishte një studente bukuroshe, që mbrëmjeve bënte edhe laviren e luksit. Në çastin që Laura Sallabanda do t'i jepte fund jetës, nga tarraca kishin hedhur një manekin prej plastike të lehtë. Mirëpo s'ishte llogaritur saktë forca e erës dhe zonjusha, në vend të binte poshtë, kishte marrë përpjetë. Kur i telefonova më vonë Albulenës për ta pyetur nëse ishte qetësuar ndopak, u përgjigj prerë. Aspak, Martin, sepse ata qenkan treguar dritëshkurtër. Për manekinen e tyre paskan imituar veshjen e një prej zonjushave më të njohura, nënkryetares së shoqatës sonë. A di të ma shkoqisësh çfarë u thotë mendja këtyre egoistëve?

Unë prapë nuk shkoqita, veçse më erdhi mirë që ajo nuk dinte gjë prej gjëje për historinë time me nënën. Ndoshta kjo ishte e pritshme. I biri nuk ekzistonte më në këtë botë as për vetë Fjonën, pasi mandatën e tij e kishte marrë nga Italia prej vitesh. Me një fjalë, për të isha një i vdekur. Por duke e ditur se Fjona ekzistonte, vetvetiu më lindi dyshimi: Vallë, është anëtarësuar ajo në këtë shoqatë?

Shoqatën e Grave Fluturuese e kishin themeluar tri zonja dhe katër zotërinj, si sponsorizuesit e parë. Nga zonjat njëra ishte arkitekthe, tjera konstruktore dhe e treta stiliste mode. Më pas, edhe pse bënin pjesë në bordin drejtues, kryesimin ia kishin besuar Albulena Polenës. Shoqata kishte zgjedhur mënyrën e saj për të protestuar kundër vetëvrasjes, duke marrë në mbrojtje sidomos seksin e dobët dhe duke u kujtuar zonjave e zonjushave se, sa të hidheshin marrëzisht nga tarracat, ato mund të fluturonin ndryshe. Dhe *ndryshe* do të thoshte të

mishëruara në balona të ngjyrshme. Shoqata krijoi degë në qytete, çdonjëra ose siguronte balodromin e vet, ose përdorte atë të fqinjit.

Balonat ndërtoheshin me skelet sa më të lehtë, ndërsa format vareshin nga qëllimi. Ishin më të thjeshta kur në tabakët e letrës do të shkruheshin thirrje, vargje poetike, ndonjë fjalë e urtë apo slogan i ri. Të parapëlqyera ishin edhe ato për florën e faunën, zakonisht lule e shpend. Për fluturimin e balonave shfrytëzoheshin rrymat ajrore që, duke ardhur nga deti, depërtonin përmes grykave të kodrave. Sapo ngriheshin dhe filli mbajtës tendosej, aktivistet u lëshonin fillin për më lart. Herë-herë në balodrom vinin edhe gazetarë, sidomos ndonjë televizion *news*, që jepte kronika të drejtpërdrejta.

Sipas njërit prej blloqeve me spirale (herë pas here kam mbajtur dhe vazhdoj të mbaj shënime), fluturaket u sulmuan shpejt. Me gjasë, sulmuesit fshiheshin prapa shkurreve të shpateve, sepse nga kodrat nisën të shtënat. E palosa një pëllumbeshë, thërriste dikush. E vrava një mjellmë, pasonte tjetri, ia shtypa kokën. Sepse ndodhte që vërtet të thyheshin shufrat e skeletit, balona mblidhej lëmsh dhe shpendi binte në çast kokëngulthi. Pastaj, kur ngriheshin fluturake të tjera, gjahtarët e shtonin ironinë. Ajo zoçka, që po mban perin e balonës, ishte thëllëzë dhe tani u bë rosë. Pse rosë? Se rosës mund t'ia hipë çdo rosak i tufës. Dhe për të mos mbetur prapa këtij hokatari, dikush shtonte më pas: Tani u bë pulë. Pse pulë? Sepse kakaris orë e çast. Hahaa andej, hihii këtej, gjahtarët gazmonin deri vonë pranë vilës sime. Mua më

zukatnin veshët, si të dëgjoja atë korin e qeshjeve dhe zgërdheshjeve në oborrin e kompleksit.

Kjo sjellje e rriti inatin e aktivisteve. Bordi vendosi që flota e balonave të pasurohej edhe me forma humane. Kështu, arkitektja, konstruktorja dhe stilistja realizuan serinë e re. Nëpër tabakë, përmasat e të cilëve u zmadhuan, tani pikturoheshin portrete zonjash e zonjushash, që i kishin të ndryshme veshjet dhe lukun e flokëve. Fytyrat e tyre shfaqnin paqe, liri dhe gëzim. Ndërsa, për të siguruar fonde nga shitoret e firmatove, rrobat ndiqnin modën e fundit. Kishte nga ato që mbanin fustane a minifunde të stinës, të tjera ca elementë të gardërobës dimërore, çizme të gjata, dorashka, shalle, xhubokse e bereta, siç kishte femra fillikat me bikini. Teksa i kundroja nga veranda me tejqrë, fluturimi i tyre më jepte ca ndjesi trazuese. Në krahun përkundruall ishte aeroporti “Nënë Tereza”, prej ku ngriheshin avionë çdo ditë, ndërsa zonjat dhe zonjushat që fërgëllonin si nimfa ajrore, dukej sikur u thoshin: “O udhëtarë, ngado shkofshi ju vaftë mbarë! Edhe në kthim do t’ju presim me urim.”

Por s’ ishte e thënë të jetonin të gjitha, as ta gëzonin lirinë ato që mbijetonin. Sulmuesit u bënë më idhnakë. Njëri nga gjahtarët, që pati punuar ca kohë si restaurues qeramikash në Athinë, u kujtua të restauronte edhe një thënie të Platonit. Meqë filozofi e pati përcaktuar njeriun si dykëmbësh pa pupla, duke parë femrat në hava, ai i mbiqajti *dykëmbëshe me pupla*. Tani konkurrentët bënë gara me njëri-tjetrin, duke marrë në shenjë pjesë të paracaktuara të trupit, sisën e majtë ose të djathtë, por sidomos pjesën e fundbarkut. Veçse batërdia e

krismave nuk mund të maskohej më prapa shkurreve, siç ishin maskuar më parë të shtënat teke, duke hedhur gurin e duke fshehur dorën. Sepse kaq u ndez tërbimi i burrave nopranë, sa krahas armëve legale, u nxorën nga skutat edhe armë pa leje. Disa qëlluan me automatikë të modelit të vjetër, dikush me mitraloz të lehtë dhe një tjetër, ish-ushtarak i divorcuar nga e shoqja, qëlloi me granatahedhës. Me ç’duket, i thanë këtij kur po e arrestonin, gruaja për ty qenka një kullë tanku. Përgjigjja: Më e rrezikshme se kulla, mua nuk më ka vrarë me predhë, por më ka bërë fërtele me zinxhirë.

Mbasdite era u shtrua, flotilja u ngrit dhe unë pata rast ta vëzhgoja sërish nga veranda. Tejqyra m’i afronte portretet deri në hollësira dhe si pa dashje, sa herë gjeja ngjashmëri me stampat e kujtesës, ngrija gishtin drejt ndonjë zonje duke murmuritur me zë:

“Brunella Marzano!.. Ariella Nuccio!.. Sabrina Tempesta!..”

Këto *signora* ishin larg, në Emilia Romagna. Por kur kisha qenë përtej detit edhe unë, i kisha kaluar në shtrat, prandaj atje më degdisnin kujtimet, balonat e mia. E jo vetëm këto, secila nga gratë që më ishte dhënë, ndodhte të më vinte si para syve. Ndonjë përmallimi të lehtë që më kaplonte, i shtoej gjithnjë marazi ndaj vetes sime, sepse edhe një si “hakmarrje” më ishte vërtitur në mendje atëherë.

Në takimin e parë Sabrina Tempesta ishte veshur gëzueshëm, duke reflektuar një festë emocionesh, të